

MELEQ SHOPI, EVIS PENI

**“ABETARE SHQIPE PËR DJELMOSHËT GEGË” E LEF NOSIT DHE
VENDI I SAJ NË HISTORINË E ABETAREVE TË SHQIPES**

1. Pak fjalë për Lef Nosin si figurë e arsimit dhe e kulturës shqiptare

Lef Nosi (emri i plotë Elefter) ka lindur në qytetin e Elbasanit më 9 prill të vitit 1877, nënshkrues i *Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë*, atdhetar, arkivist, folklorist, etnograf, numizmat, arkeolog e politikan shqiptar. Njihet si “babai” i filatelistë shqiptare. Veprimtaria e tij politiko-shoqërore ishte pothuajse e pandarë me atë personale. Pranë Arkivit Qendror Shtetëror tërësia e letrave të ardhura në adresë të tij arrin më tepër se 1200.

Lef Nosi u arsimua fillimisht në vendlindje e më pas në Athinë për farmaci, por nuk i përfundoi studimet. Kreu vetëm 2 vjet. Pas kthimit në qytetin e tij, iu kushtua me zell të veçantë punës për njohjen e gjerë dhe të thelluar të historisë dhe të kulturës shqiptare. Formimi i tij intelektual relativisht shëndoshë dhe dashuria për atdheun, qenë shtysat e forta që Nosi të fitonte rolin e merituar të një veprimtari të shquar dhe, madje, të bëhej edhe protagonist i ngjarjet e stuhishme, që i paraprinë ngritjes së flamurit kombëtar në Vlorë. Veprimtaria e ngjeshur kombëtare e bëri shumë shpejt Lef Nosin objekt ndjekjeje për autoritetet osmane. Në 1902 u padit dhe u procedua, por shpëtoi pa u dënuar, sepse nuk iu provua fajësia. Ideja e Lef Nosit për Shtetin e Ri Shqiptar mori formë në programin politik që, së bashku me Faik Konicën, botuan në Londër më 1907. Lëvizja politike u quajt *Ana Kombëtare* dhe programi i saj përmbante 24 pika. Forma qeverisëse do të ishte monarkia. Shteti i ri shqiptar do të kishte në përbërjen e tij katër vilajetet e Perandorisë Osmane: Janinën, Kosovën, Manastirin dhe Shkodrën. Shteti shqiptar të ishte shtet laik. Pikat e tjera të programit tregojnë se për organizimin e brendshëm, me zgjedhje, përfaqësues dhe administratë, programi ishte mbështetur gjerësisht në traditën e popullit shqiptar. Më 1909, Lef Nosi u zgjodh kryetar i Klubit “*Vllaznia*” në Elbasan. Mori pjesë në Kongresin e Manastirit dhe kërkoi që Kongresi i Manastirit të bëhej në Elbasan, por delegatët nuk pranuan dhe ai shkoi në Kongres, por pa të drejtë vote, ndërsa një vit më vonë botoi gazetën “*Tomorri*” ku kishte përkrah Aleksandër Xhuvanin, Luigj Gurakuqin, Simon Shuteriqin, Kristo Dakon (25 III 1910). Lef Nosi ishte një nga figurat qëndrore që kontribuan në organizimin dhe zhvillimin e *Kongresit Arsimor Kombëtar të Elbasanit* (tetor 1909), si edhe të çeljes të së parës shkollë normale në vend (1 dhjetor 1909). Pikërisht në këtë kohë u bë i njohur për shkrimet e spikatura dhe artikujt e përkthyer nga shtypi evropian ku trajtoheshin çështjet e aktualitetit dhe interesat kombëtare shqiptare. Dy artikuj të përkthyer nga shtypi evropian do të bëheshin shkak që turqit e rinj ta arrestonin drejtorin e Shkollës Normale më 7 gusht 1910 në Elbasan dhe, katër ditë më vonë, dënohet nga një

gjykatë ushtarake dhe internohet në Bursë të Turqisë. Ndërkohë qeveria e re e xhonturqve kishte nisur një fushatë kundër çdo gjëje që shprehte lëvizje për pavarësi, sidomos ndaj atyre që shpreheshin në gjuhën shqipe. Përballë këtyre sulmeve u gjend dhe Normalja e Elbasanit, të cilën qeveria osmane e mbylli në tetor të vitit 1910. Në këto kushte Fan Noli nga Bostoni i shkruante Lef Nosit në Elbasan, se do të ishte mirë dhe njëkohësisht një goditje për qeverinë osmane që Normalja të transferohesh jashtë tokave shqiptare në ndonjë shtet të Evropës. *“Bisedojeni këtë çështje me miqt’ e atjeshme dhe shkruamëni që të di. Jam gatë dhe unë dhe z. Faik bej Konitza të vemi të gjithë në Svicërë dhe të bëhemi të gjithë profesore atje dhe të gatitim një racë të re për Shqipërinë e nesërme.*

Sikundër ka theksuar edhe profesor Kujtim Bevapi, Lef Nosi ka qenë ihtar i Mjedës dhe i Atë Gjergj Fishtës, në variantin shkodran të hartimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Kjo duket edhe në Abetaret e botuara prej tij si “Editor”, sikundër janë, së pari, *“Abetarja shqipe e T.P.”*, botuar më 1911 në Manastir, që ka titullin *“T.P.Abetare për shkolla fillore, meshkuj e femna, në ligjërojë t’Elbasanit, me pak ndryshime”, Shtypje e parë, Editor Lef Nosi, Elbasan, Manastir, Shtypur në dhp. “Tregëtare Nerkombëtare, 1911”*, e cila është përfshirë në vargun e abetareve të njohura të shqipes edhe në studimin e Sh. Osmanit e Nj. Kazazi¹. Më vonë, më 1912, po në Manastir e po në të njëjtën shtypshkronjë do të botohej edhe një abetare tjetër, me editor Lef Nosit dhe me titullin: *ABETARE SHQIPE, Për Djelmoshët Gegë, Shtypje e Parë; Editor: Lef Nosi, ELBASAN, Manastir, Shtypshkronja “Tregëtare Nerkombëtare”, 1912.* Theksojmë se kjo abetare, të cilën ne e kemi gjetur dhe na ka ndihmuar Biblioteka Publike “Qemal Baholli” Elbasan, nuk pasqyrohet në librin e studiuesve Sh.Osmani e Nj.Kazazi. Kjo është edhe arsyeja që, në rreshtat e kumtesës sonë, në kuadrin e analizës së botimeve të Lef Nosit, po ndalemi edhe në disa shqyrtime filologjike rreth alfabeve dhe dukurive gjuhësore të pasqyruara në këtë libër nën kujdesin e Lef Nosit, si kryetar i shoqërisë *“Afërdita”* në Elbasan (1909).

Botoi fletoren *“Dokumenta historike per t'i sherbye histories tone kombetare”* dhe në 1937 një fletëpalosje me Aktin e Pavarësisë të vitit 1912, me rastin e 25-Vjetorit. Ka pasur letërkëmbim të pasur me personalitete të njohura të politikës ndërkombëtare, albanologjisë, gjuhësisë e historisë; ndër këto personalitete ka qenë dhe studiuesja skoceze Margaret Hasluck. Në kujtimet e Margaret Hasluck-ut nënvizohet se *“pa përkrahjen e Lef Nosit nuk do të mund të kishte nxjerrë në dritë shkrimet e saj”* dhe ajo, në fakt, qëndroi në Shqipëri nga 1923-'39, duke përshkuar viset më të skajshme të vendit për 13 vjet, e apasionuar mbas folklorit e traditave shqiptare. Personalitetet e kohës, sikundër dhe miku i saj më i afërt, Lef Nosi, e kanë cilësuar si gjeografe, gjuhëtare, epigrafe, arkeologe, dijetare, etnologue e kulturës shqiptare. Margaret Hasluck-u në vitin 1932 botoi librin *“Albanian – English Reader”*. Në të përmbledheshin 16 histori folklori të përkthyer me dy gramatika dhe fjalorë. Gjithashtu, Lef Nosi ka pasur bibliotekën e dytë personale

¹ Shih: Sh. Osmani dhe Nj. Kazazi, *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike*, Tiranë, 2000, f. 178-183.

më të madhe në Shqipëri pas asaj së Mithat Frashërit. Ajo bibliotekë më vonë u bë themel i Bibliotekës Kombëtare në Tiranë. Bërthama e fondit të albanologjisë dhe ballkanologjisë në bibliotekën publike “Qemal Baholli” në Elbasan mban vulën personale të Lef Nosit.

2. Vendi i “Abetares shqipe për djelmoshat gegë” në historikun e abetareve shqipe. Në librin “Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike” të autorëve Shefik Osmani dhe Njazi Kazazi (Tiranë, 2000), jepet edhe vlerësimi e vendi që i takon Lef Nosit si editor (botues) i librit “Abetare për shkolla fillore meshkujsh e femnash” (*Shtypj’e parë*), me autor Dhimitër Paparisto, por nuk flitet fare për librin tjetër me titull “Abetare Shqipe. Për djelmoshat gegë” *Shtypj’e parë, Editor Lef Nosi, Elbasan, MANASTIR, Shtypshkronja “Tregtare Nerkombetare”, 1012.*

Në krye të faqes së parë, nga e djathta ka të shkruar me shkronja të shkriftë kapitale L.K. (Autori anonim). Në faqen e fundit, në mes të saj, shkruhet “Kushton 20 para”.

Në faqen 3 jepet “Abeja shqipe” e përbërë nga shkronjat latine dhe nga disa shkronja të marra nga alfabeti grek. Në fillim jepen të shkruara me të vogla shtypi, kurse në vijim, më poshtë, po ato shkronja me kapitale. (Shih: Faksimilen përkatëse).

Faqe 4-9 pasqyrohen shkronjat zanore, pastaj ato bashkëtingëllore, duke i përdorur në shoqërim me bashkëtingëllore të ndryshme, si:

ab,ad,ag,aj,aç,an,ar,ath,av,ac,adh,ak,am,ap,arr,at,ax,az,af,ah,al,aq,as, an, aq.

Po kështu jepen edhe zanore të tjera, të shoqëruara me bashkëtingëllore përkatëse në fjalë. Gjithashtu në abetare nuk mungojnë edhe shembujt me shkronjat në fjalë, të ndara në rrokje dyshe a treshe si:

dora, nani, çika, fytyra etj.

Përmes një pasqyre të plotë të alfabetit, sidomos ai me shkronja latine të Kongresit të Manastirit trajtohen edhe një varg faktorësh me rëndësi njohëse, historike, shoqërore e mirëfilli pedagogjike e gjuhësore rreth saj, të cilat do t’i analizojmë në vijim. Të tilla si:

Jeta e njeriut: Familja, Shtëpia, Katundi, Qyteti; Faltorja e Mësimtorja; Kombi dhe Gjuha amtare; Atdheu, Liria, Dituria.

Vihet re se nuk kemi të bëjmë me një abetare mirëfilli, me një tekst mësimor ku fillon shkrimi dhe mësimi i çdo gjuhe, por me një tekst, me një përmbajtje ku trajtohen edhe probleme apo tema të kohës, përmes teksteve të shkurtra që përshkohen nga fryma atdhetare, liridashëse dhe arsimdashëse.

Pra, duket sikur është e ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë (f. 3-11) paraqitet alfabeti, shkronjat e dorës dhe alfabeti thjesht latin i vendosur në Kongresin e Manastirit.

Pjesa tjetër përbëhet nga copëza letrare, nga jeta shoqërore dhe ajo politike (f. 11-16). P.sh. në pjesën “Jeta e njeriut” përcillet idea se njeriu nuk mund të kuptohet jashtë shoqërisë, familjes, vendit në të cilin ai jeton e punon. Edhe pse nuk është autori i kësaj vepre, në qoftë se do ta quanim të tillë, por botuesi i saj,

editor, idetë apo pikëpamjet dhe njohuritë e shprehura në këto shkrime qëndrojnë në një nivel me ato të Lef Nosit.

Në tekstin “*Faltoreja e Mësimtorja*” autori “L.K”, të cilit edhe sot nuk i dihet anonimati, jep vlerat e besimit në fe dhe që janë baras me vlerat e vendin e Mësonjëtores ku duhet të shkojë i madh e i vogël.

... Në mësimtoreset, duhet të shkojë çdo njeri kur asht i vogëlë, se aty mësojmë shumë gja. Mësojmë me sa ditnie e ka krijume perëndia gjithësisen; mësojmë se duhet të nderojmë mretin, prindët, të parët e fesë edhe pleqtë;... (f. 11)².

Ndërsa në pjesën “*Kombi dhe Gjuha amëtare*” dalin në pah vlerat e gjuhës, sidomos gjuhës së shkruar.

... një gjuhë që ka metë e pashkrueme, asht si ai i vdekuni qi ka metë pa shtie në dhe’, edhe duke shkume koha humb fare nga faq’ e dheut (f. 12)

Abetarja mbyllet me tekstin “*Atdheu, Liria, Dituria*”(prej 9 faqesh) ku pasqyrohen tri gjërat me të shtrenjta dhe më të vyera për njeriun.

... vendi ku kemi lemë quhet atdhe, Atdheu i gjithë atyne që flasin shqip asht Shqipnia...

Shqiptarët sado që janë të damë nga feja, se ca janë të Krishtenë e ca Myslimanë, po nga atdheu janë të bashkume (f. 14).

Idea se shqiptarët janë një e të pandarë, pavarësisht nëse janë myslimanë e të krishterë, janë dhe mbeten një. Kjo ide e hedhur nga Rilindësit tanë do të ishte dhe motivi i viteve 1912-të, pasi ky vit do të ishte dhe viti i Pavarësisë.

Por nuk mund të kuptohet atdheu gjithashtu pa lirinë e vyer dhe e kërkuar prej kohësh, aq më tepër njeriu pa të. E kjo gjen vendin e saj në shprehjen:

... Lirinë tonë kombëtare duhet t’a cmojmë shtrejt, e vetëm kur të humi jeta jonë at’here let’humit dhe ajo (f. 15).

Fragmenti me të cilin mbyllet kjo abetare tingëllon sa real për kohën që është shkruar aq edhe për ditët e sotme:

... Pra vllazën gjith’na që jena shqiptare, që flasim një gjuhë, që kena një gjak; let duam njeni tjetrin e let përpiqemi t’a lulëzojmë Shqipnien (f. 16).

Në këto shkrime sikur lexojmë idetë e këtij patrioti, të cilat do t’i shpalosë në gjithë veprimtarinë e vet të shkrimtarisë. Dhe për hir të së vërtetës, Lef Nosi do të mbetej ndër ato intelektualë, formimi i të cilit do të rritej dhe do të shfaqej në të gjitha botimet e asaj periudhe, sidomos në publicistikë, politikë, në fushën letrare e gjuhësore. Ky intelekt, ky mendim sa intelektual e shqiptar miratohet më së qarti edhe në vlerat e “*Abetarja Shqipe. Për djelmoshët gegë*”.

Lindja e një kombi duhen fort shoq me shoq, se përveç gjuhës, janë vllazën edhe nga gjaku, zakonet e vetitë... ne që flasim shqip, përbëjmë kombin shqiptar.

Përveç këtyre trajtesave do të vihet re se në faqen 12, në pjesën “*Kombi dhe Gjuha amtare*” të kësaj abetareje citohet:

² Shënim: në vjeljen e materialit nuk e kemi shkruar ashtu siç është në origjinal, pasi në to janë përdorur edhe shkronja të alfabetit turk. Shembujt i kemi dhënë në një gegërishte, siç mund të flitet sot.

Abetare shqipe për djelmoshët gegë e Lef Nosit dhe vendi i saj...

... sa i nevojshëm ashtë shkrimi e këndimi i gjuhës shqipe, për të na rujtë kombësin, aqë ma i nevojshëm ashtë, për nevojat e botës që na shfaqen përditë...

I kemi shkëputur këto rreshta jo pa qëllim, pasi shqyrtohen idetë e shprehura në thëniet e njërës prej dorëshkrimeve të mbesës së L.Nosit, e cila pohon se Lefi po përpiqej të vërtetonte se gjuha shqipe është shkruar para Buzukut dhe se kjo gjuhë i përket popullit dhe kombit shqiptar. Të gjitha këto burime sipas saj i kishte nga zona e Shpatit e luftonte për këtë punë.

Pra, për Lef Nosit *Shqipja* dhe *Kombi* shqiptar janë një. Dhe veprimtaria e tij shkrimore nuk do të pushojë së reshturi. Qëllimi që i kishte vënë vetes për të çuar deri në fund luftën për çështjen kombëtare nuk do ta ndalë në botimet dhe shkrimet e veta të mëtejshme.

Në artikujt e botuar me karakter historik, kulturor, shkencor si: “*ç’asht ditarësia (gazeta)*”, “*Jeta e Pirros*” (Përkthim nga Plutarku), “*Himara e Bregu i Detit*”, “*Pjesë nga Meshari i Buzukut përmes një këndvështrimi përqasës*” dhe “*Cilët janë shqiptarët*” etj., i bëhej jehonë të gjitha çështjeve e shqetësimeve kombëtare e më tepër problemeve që lidheshin me arsimin, ecurinë e Shkollës Normale, etj. (Të gjitha këto shkrime janë vjelë nga gazeta e asaj kohe “*Tomorri*”).

Në shkrimet e tij, në të parën gazetë të Elbasanit “*Tomorri*” ku do të bëhej i njohur edhe me artikujt e përkthyer nga shtypi europian, ai do të shpalosë çështje të aktualitetit, interesat kombëtare shqiptare. Si njohës mjaft i mirë i disa gjuhëve të huaja dhe studiues i vlerave dhe historisë së Shqipërisë, ai blinte rregullisht libra të shkruara për vendin tonë dhe siç theksohet edhe nga bashkëkohësit, këto libra ia ka pas dhuruar bibliotekës.

Gjithashtu, ky personalitet në një botim të vitit 1924 do të trajtojë probleme të historisë sonë kombëtare, me dokumente që i përkasin periudhës kohore 1912-1918 si telegrame, letërkëmbime, fonograme, shkresa, kujtime, etj. Arrestuar nga turqit, internuar nga italianët dhe më në fund i pushkatuar nga komunistët, ai nuk do të jepej përpara askujt. Në librin me kujtime “*Rrno vetëm për me tregue*” të At Zef Pllumit do të shkruhet:

...Ndersa Lef Nosi, një zotni i mbajtur që nuk e kishte shokun ndër shqiptarë, nuk tundej fare:un-thonte, nuk i kam ba keq kurrkujt: gjithmonë në jetën time kam ba veç mirë, prandaj as komunist, as kurrkush tjetër nuk kanë pse më kërkojnë llogari, dhe vazhdon të qetë tue kontrollue koleksionin e fundit të pullave të postës e me një lente të madhe kqyrte a kishin dalë mirë e kuart germa e vulave postare më të fundit...³

Profesor Tomorr Plangarica do të pohojë me të drejtë në studimet e tij:

... Ka personalitete që veprën e tyre të shkruar e kanë të mbushur me shqetësime, ankth, bukuri njerëzore e kanë të mbushur me jetë të vërtetë. Ka gjithashtu personalitete që mund të mos kenë vepër të tillë të shkruar, por jetën e tyre e kanë mbushur me shqetësime për njerëzit, me veprimtarinë për të qëmtuar dhe

³ Atë Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, 1995.

*evidencuar bukurinë njerëzore, traditën dhe vlerat e kombit, për t'i dhënë jetë dhe shpresë atij.*⁴

Lef Nosi do të ishte dhe do të spikatet ndër personalitetet që do t'i përkasë asaj plejade njerëzish, jo vetëm si njeri me vlera njerëzore, por edhe si njeri me një jetë të mbushur plot me veprimtari të papërsëritshme në epokën ku jetoi e punoi.

BIBLIOGRAFI

- A. Boçe, *Lef Nosi, një gur për pavarësinë*, Gazeta "Shekulli" (16/04/2012).
Atë Z. Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, Tiranë, 2006.
M. Sadiku, *Dokumentet, si u pushkatua Lef Nosi...*, Gazeta "Panorama" (31/01/2012).
R. Elsie, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, 2012.
Sh. Osmani dhe Njazi Kazazi, *Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historike pedagogjike*, Tiranë, 2000.
T. Plangarica, *Univers i vlerave të munguara*, Studime, Botimi i dytë, 2002.

⁴ T. Plangarica, *Univers i vlerave të munguara*, Për Lef Nosin dhe gazetën e tij "Tomorri", Studime 2000, f. 99.